

## Komunikatë për Shtyp

Lezhë, Shënkoll më 27.05.2010

Qendra Komunitare Shënkoll, ditën e enjte datë 27 Maj, 2010, nga ora 10.00 – 12.30, organizoi në ambjentet e saj festimin e "Ditës Kulturore".

Ky aktivitet është pjesë e aktiviteteve që kryhen në kuadër të grantit nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB) nëpërmjet Norway Trust Account. Ky grant akordohet për asistencën teknike për monitorim-vlerësimin dhe vizibilitetin e Programit "Rrugët Dytësore e Lokale".

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin Prefekti i Qarkut Lezhë Z.Pal Dajçi, përfaqësues të Drejtorisë Arsimore të rrethit, nxënës dhe mësues të shkollave 9-vjeçare të Komunës Shënkoll, banorë të fshatrave përreth, si dhe përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që ka mundësuar ngritjen e kësaj qendre.

Aktiviteti u hap nga Z. Fran Rrokaj, Kryetar i Komunës. Z. Benet Beci, Drejtor Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit përshëndeti pjesëmarrësit në këtë aktivitet. Më tej aktiviteti vijoi me një program artistik, ekpozitë, ndeshje futbolli ndërmjet ekipit të FSHZH-së dhe ekipit të Shënkollit. "Dita Kulturore" vazhdoi me dhënien e disa çmimeve për piktorin më të mirë si dhe kupën për ekipin fitues.

Ky aktivitet u organizua në kuadër të informimit publik lidhur me realizimin e punimeve për segmentin rrugor ish SMT – Rrilë Shënkoll. Ky segment është i gjatë 8.1 km dhe gjerësia e tij shkon deri në 6 m. Gjithashtu është bërë ndërtimi i tombinove të reja të cilat lehtësojnë lëvizjen e ujërave, bankina për këmbësorët në të dy anët e rrugës etj. Rruga është e pajisur me sinjalistikën e duhur horizontale dhe vertikale përgjatë gjithë gjatësisë së saj. Të njëjtat punime po kryhen dhe në segmentin tjetër 6.2 km te gjate, Shënkoll-Tale-Hidrovor, punime të cilat pritet të përfundojnë pas 5 muajsh. Tek të 14.3 km e sipërpermendura, cilësia e punimeve është shumë e lartë dhe janë respektuar standartet europiane.

Në fund të aktivitetit u krye edhe pastrimi vullnetar i plazhit të Tales duke e përgatitur për sezonin e ri veror, si dhe u shpërndanë fletëpalosje për sigurinë rrugore dhe mirëmbajtjen e saj.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit i cili ishte i ftuar në këtë aktivitet si donator ka financuar në vite, 6 (gjashtë) projekte infrastrukture me një vlerë të përafërt prej 185, 000,000 lekë. Ndërsa për periudhën 2009-2010, në kuadër të Projektit të Rrugëve Dytësore dhe Lokale.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një institucion që nxit një zhvillim social-ekonomik të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e lokal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit. Aktualisht FSHZH po realizon projektin "Përmirësimi i Rrugeve Dytësore dhe Lokale në Shqipëri", projektin e "Ujësjellësave Ruralë " si dhe projektin "Punët Në Komunitet III". Këto projekte mundësohen me financimet e Bankës Botërore, Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës, Banka Gjermane KFW, Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), Banka Europiane e Investimeve, Banka Islamike për Zhvillim etj.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që nga krijimi i tij në 1993, ka realizuar 126 projekte infrastrukture në Qarkun e Lezhës. Nga këto investime, në rrethin e Lezhës janë implementuar deri më sot 60 objekte të infrastrukturës parësore ; prej të cilave 19 janë ndërtime segmentesh rrugore, 23 ujësjellës-kanalizime, 6 vepra ujitje&mbrojtje nga përmbytjet, 3 ndërtesa publike, 2 qendra shëndetësore, 1 Qendër Komunitare dhe 3 nënprojekte mjedisore dhe kulturore. Vlera totale e projekteve të financuara në këtë rreth deri në Maj 2010 arrin shifrën prej 1, 200, 000,000 (qendër komunitare, shkolla) dhe një projekt ujitje. Aktualisht, FSHZH është duke implementuar tre nënprojekte rrugësh me një vlerë prej 670, 500, 000 lekësh. Këto nënprojekte janë: Rikonstruksioni i rrugës Kallmet-Nënshat, rikonstruksioni i rrugës Lezhë-Kallmet, dhe Rikonstruksioni i rrugës ish-SMT Lezhë-Rrilë.

Për më tepër informacion rreth ecurisë së projekteve të FSHZH-së, mund të vizitoni faqen e internetit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit [www.albaniandf.org](http://www.albaniandf.org)